V E N D I M
Nr.591, datë 13.12.1993

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.48, DATË 29.1.1993 "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7652, DATË 23.12.1992 "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE"

Me propozimin e Komitetit të Ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

Pika 13 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.48, datë 29.1.1993 "Për zbatimin e ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", ndryshohet si vijon:

"Komiteti i Ish-të Përndjekurve Politikë, nëpërmjet degëve të tij në rrethe, për Tiranën, nëpërmjet degëve të rajoneve, të hartojë listat e personave që përfitojnë "statusin" e ish-të përndjekurve politikë nga sistemi komunist dhe t'i dërgojë ato pranë këshillave të rretheve dhe bashkive".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi